



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 20.05.2024

Shtojca 11

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

Drejtuar: Operatori ekonomik "PEPA GROUP GROUP" sh.p.k.

Adresa: Autostrada Tirane- Durres, km 6, Rruga dytesore "Iliria", Kashar, Tirane.

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedure e Hapur**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF- 91765-12-20-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **Objekti i kontrates: "Rikonstruksioni i godines se anatomisë", Universiteti i Mjekesise, Tiranë**, me kohezgjatje 8 (tete) muaj nga data e fillimit te punimeve.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Nuk aplikohet.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

NR	SHOQERIA		OFERTA PA TVSH
1	"INERTI" SHPK	INERTI J66926804L	50,555,121.15 (pesëdhjetë milion e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e njëqind e njëzet e një presje pesëmbëdhjetë) lekë
2	"LIS KONSTRUKSION" SHPK	LIS KONSTRUKSION K66613407H	51,337,793.00 (pesëdhjetë e një milion e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë
3	"ERGI" SHPK	ERGI K02727229P	58,810,007.10 (pesëdhjetë e tetë milion e tetëqind e dhjetë mijë e shtatë presje një) lekë
4	"INA" SHPK & "XHENGO" SHPK	INA J61814009W XHENGO SHPK J64103171M	58,866,757.65 (pesëdhjetë e tetë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë presje gjashtëdhjetë e pesë) lekë
5	"ANTE-GROUP" SHPK	Ante-Group J62904100D	61,166,863.00 (gjashtëdhjetë e një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë

6	"KEVIN KONSTRUKSION" SHPK	KEVIN KONSTRUKSION K71401004W	61,673,671.00 (gjashtëdhjetë e një milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një) lekë
7	"PEPA GROUP GROUP " SHPK	PEPA GROUP GROUP L42215009L	63,146,453.05 (gjashtëdhjetë e tre milion e njëqind e dyzet e gjashtë mijë e katërqind e pesëdhjetë e tre) lekë
8	"G&M CONSTRUCTION 07" SHPK & "METEO" SHPK	"METEO".SH.p.k L26310801C G & M CONSTRUCTION 07 M21313027A	65,048,131.68 (gjashtëdhjetë e pesë milion e dyzet e tetë mijë e njëqind e tridhjetë e një presje gjashtëdhjetë e tetë) lekë
9	"SENKA" SHPK	SENKA J94808405Q	65,732,624.90 (gjashtëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e tridhjetë e dy mijë e gjashtëqind e njëzet e katër presje nëntë) lekë
10	"LTE CONSTRUCTION" SHPK & "COLOMBO" SHPK	C O L O M B O J82916489E L.T.E CONSTRUCTION L78006801F	66,027,666.30 (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e njëzet e shtatë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje tre) lekë
11	"MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE" SHPK & "MALAJ COMPANY" SHPK	MALAJ COMPANY K72125009O MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE K81314023A	66,585,598.42 (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e pesëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë presje dyzet e dy) lekë
12	"AGRI CONSTRUCTION" SHPK	AGRI CONSTRUCTION - K01725001F	67,116,858.25 (gjashtëdhjetë e shtatë milion e njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e tetë presje njëzet e pesë) lekë
13	"LEON KONSTRUKSION" SHPK	LEON KONSTRUKSION K71820009I	69,715,283.59 (gjashtëdhjetë e nëntë milion e shtatëqind e pesëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e tre presje pesëdhjetë e nëntë) lekë
14	"KACDEDJA" SHPK	K A C D E D J A K51712017A	71,311,414.25 (shtatëdhjetë e një milion e treqind e njëmbëdhjetë mijë e katërqind e katërmëdhjetë presje njëzet e pesë) lekë
15	"DESARET COMPANY" SHPK & "AURORA KONSTRUKSION" SHPK	AURORA KONSTRUKSION K02017003I DESARET COMPANY K01816001J	71,475,919.86 (shtatëdhjetë e një milion e katërqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë presje tetëdhjetë e gjashtë) lekë
16	"ERAL CONSTRUCTION COMPANY" SHPK	ERAL CONSTRUCTION COMPANY K82230002K	71,992,323.95 (shtatëdhjetë e një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e treqind e njëzet e tre presje nëntëdhjetë e pesë) lekë
17	"2N" SHPK	2 N L31615017L	72,618,090.00 (shtatëdhjetë e dy milion e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e nëntëdhjetë) lekë

18	"IGROUP" SHPK	IGROUP M01406012K	Pa ofertë ekonomike
19	"ZEQILLARI" SHPK	ZEQILLARI L61912024O	Pa ofertë ekonomike

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. BOE “L.T.E CONSTRUCTION” SHPK ME NUIS L78006801F (32%) DHE “C O L O M B O” SHPK ME NUIS J82916489E (68%).

Shoqeria “L.T.E CONSTRUCTION” shpk me NUIS L78006801F nuk ploteson kerkesen 2.3.1 te kerkesave te vecanta per kualifikim ku kerkohet:

2.3.1 *Operatorët ekonomikë duhet të kenë përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme dhe për këtë duhet të paraqesin :*

- dokumentacion për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;*
- dokumentacion për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e ulët se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- *Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:*
- *Kontratë Sipërmarrje;*
- *Situacionin përfundimtar;*
- *Faturat tatimore;*
- *Aktin e kolaudimit;*
- ***Certifikaten e marrjes ne dorezim te perkohshem/perfundimtar.***

Shënim : *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm :

- *Kontrate Sipërmarrje;*
- *Situacionin përfundimtar;*
- *Faturat tatimore;*
- *Akt kolaudimi objekti.*
- *Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet te paraqesë edhe Kontraten e bashkimit te operatoreve shoqeruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku te cilësohen punimet qe ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.*
- *Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.*

Per te provuar plotesimin e ketij kriteri kjo shoqeri ka paraqitur punen me objekt: “Rikonstruksion godine ekzistuese me 2 kat dhe 1 kat podrum” me investitor institutin e Sigurise Ushqimore dhe Veterinarise ne Tirane. Objekti ka vlere totale 33.893.103.43 leke me tvsh. Kontrata eshte lidhur ne daten 26.03.2020 dhe afati i perfundimit, referuar formularit te vlersimit, eshte 25.05.2020. Per kete kontrate nuk eshte paraqitur certifikata e marrjes perfundimtare ne dorezim, ndonese afati per marrjen e kesaj certificate ka qene data 13.06.2022.

Shoqeria “C O L O M B O” shpk me NUIS J82916489E nuk ploteson kerkesen 2.2.3. te kerkesave te vecanta per kualifikim ku kerkohet:

2.2.3 *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me percaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar apo ushtrojnë aktivitet, për vitin 2022 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2023.*

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2022 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2023.

Shënim : *Operatorët ekonomikë për përmbushjen e kësaj kërkesë duhet të vetëdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST, se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me percaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar apo ushtrojnë aktivitet, për vitin 2022 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2023.*

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Operatori ekonomik ne formularin e vetedeklarimit ka deklaruar se ka paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me percaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet, për vitin 2022 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2023. Personi i ngarkuar me shqyrtimin e ankeses shqyrtoi dokumentat origjinale apo fotokopje te noteruara qe BOE “L.T.E CONSTRUCTION” shpk me NUIS L78006801F (32%) dhe “COLOMBO” shpk me NUIS J82916489E (68%) kane paraqitur prane autoritetit kontraktor. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se shoqeria “COLOMBO” shpk ka paraqitur vertetime se ka shlyer detyrimet e taksave dhe tarifave vendore ne Fier per vitet 2022 dhe 2023 dhe ne Patos per vitin 2023. Ka paraqitur gjithashtu nje vertetim te leshuar nga bashkia Kamez ne te cilin vertetohet se nuk ka detyrime ndaj bashkise kamez pasi nuk ka seli te regjistruar ne kete qytet. Nga verifikimi i pagesave te thesarit ne faqen https://spending.data.al/sq/treasury/list/year/2019/perf_id/COLOMBO rezulton se kjo shoqeri ka kryer aktivitet edhe ne bashki te tjera e konkretisht:

1	Spitali Lushnje (0922)	COLOMBO	6,609,918	1013022 Spitali Ihsan Cabej Lushnje per sa lik Rik.godines se urgjences, sit.perfund.dt.11.03.2022 ,fat.fisk.nr.12 dt.12.04.2022,akt kolaudim nr.344/2 dt.11.03.2022,akt marrje perkohshme dorezim dt.17.03.2022,kontr.nr.1282/12 dt.26.01.2021
2	Spitali Lushnje (0922)	COLOMBO	3,792,491	1013022 Spitali Ihsan Cabej Lushnje per sa lik Rikonstr.urgjences,fat.fisk.nr.15 dt.13.04.2022,situac.perf.dt.18.12.2021,Akt kolaudimi nr.344/2 dt.11.03.2022,Akt marrje perkoh.dorz.dt.17.03.2022, kontr.shtese nr.1210 dt.10.12.2021

3	Bashkia Selenice (3737)	COLOMBO	5,740,641	Trajtim reshqitje rruga fshati peshkepi kontrate nr 1812/1 dt 06.09.23 Bashkia Selenice 2159001 u.prok 92 dt 12.07.2023 fat 24 dt 19.10.2023 situacion nr1
4	Bashkia Selenice (3737)	COLOMBO	5,577,421	Trajtim reshqitje rruga fshati peshkepi kontrate nr 1812/1 dt 06.09.23 Bashkia Selenice 2159001 fat 32 dt 26.12.2023 situacion perfundimtar certifikat e perkoheshmedt 15.11.2023 pv kolaudimi dt 28.12.2023

Aktualisht shoqeria “COLOMBO” shpk:

- nuk ka paraqitur vertetime per shlyerjen e detyrimeve ne Lushnje per vitin 2022, per kontraten shtese te lidhur me spitalin Ihsan Cabej ne daten 10.12.2021 qe ka perfunduar ne daten 11.03.2022.
- nuk ka paraqitur vertetime per shlyerjen e detyrimeve ne Selenice per vitin 2023, per kontraten e lidhur me bashkine Selenice ne daten 06.09.2023 qe eshte kolauduar ne daten 28.12.2023.

Autoriteti kontraktor ne percaktimin e kesaj kerkese per kualifikim eshte bazuar ne Ligjin 9723, date 03.05.2007, i ndryshuar “Per Regjistrimin e Biznesit”, konkretisht ne dispozitat ligjore te meposhtme:

Nenin 22 “Detyrimi per Regjistrim”, pika 4 ku citohet:

“Aplikimi per ndryshimin e selise dhe hapja e vendeve te tjera te ushtrimit te veprimtarise behet brenda 30 diteve kalendarike nga data e vendimit perkates, por ne cdo rast, perpara nisjes efektive te veprimtarise ne ate vend”, si dhe Nenin 43 “Regjistrime te tjera te detyrueshme” pika 3/d ku citohet:

“Perverc sa parashikohet ne piken 1 te ketij neni, subjekti duhet te regjistroje dhe te depozitoje aktet perkatese, si me poshte:..... d. Vendet e tjera te ushtrimit te veprimtarise, te ndryshme nga selia”

Ky ligj percakton si detyrim te personit juridik regjistrimin e vendeve e tjera te ushtrimit te veprimtarise. Me vende te tjera te ushtrimit te veprimtarise do te kuptojme ushtrimin e saj ne vende te ndryshme nga selia e personit juridik.

Gjithashtu autoriteti kontraktor eshte bazuar edhe ne nenin 43 te ligjit 9920, date 19.05.2008, i ndryshuar, ”Per Procedurat Tatimore” pika 1/1 ku citohet:

“Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, në çdo rast bëhen përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend. Për hapjen e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me një certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm. Kjo certifikatë lëshohet për të identifikuar vendndodhjen e ushtrimit të veprimtarisë, kur është e ndryshme nga selia.”.

Duke qene se regjistrimi i vendeve te aktivitetit eshte detyrim ligjor, autoriteti kontraktor nuk ka kerkuar vertetime vetem per vendet e regjistruara ne QKB, por ne gjithe vendet ku operatori ekonomik ushtron aktivitet edhe nese, ne menyre te kundraligjshme, nuk ben regjistrimin ne QKB. Nisur nga sa me siper, shoqeria “Colombo” shpk nuk e ploteson kete kerkese per kualifikim.

Shoqeria “L.T.E CONSTRUCTION” shpk me NUIS L78006801F nuk ploteson kerkesen 2.2.3. te kerkesave te vecanta per kualifikim ku kerkohet:

2.2.3 *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me percaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar apo ushtrojnë aktivitet, për vitin 2022 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2023.*

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2022 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2023.

Shënim : *Operatorët ekonomikë për përmbushjen e kësaj kërkesë duhet të vetëdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST, se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me percaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar apo ushtrojnë aktivitet, për vitin 2022 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2023.*

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Operatori ekonomik në formularin e vetëdeklarimit ka deklaruar se ka paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me percaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet, për vitin 2022 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2023. Personi i ngarkuar me shqyrtimin e ankesës shqyrtoi dokumentat origjinale apo fotokopje të noteruara që BOE “L.T.E CONSTRUCTION” shpk me NUIS L78006801F (32%) dhe “COLOMBO” shpk me NUIS J82916489E (68%) kanë paraqitur pranë autoritetit kontraktor. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se shoqëria “L.T.E CONSTRUCTION” shpk ka paraqitur vërtetime se ka shlyer detyrimet e taksave dhe tarifave vendore në Tiranë për vitet 2022 dhe 2023.

Nga verifikimi i pagesave të thesarit në faqen:

https://spending.data.al/sq/treasury/list/year/2019/perf_id/L.T.ECONSTRUCTION/from_date_reg/2022-01-01/to_date_reg/2023-12-31

rezulton se kjo shoqëri ka kryer aktivitet edhe në bashki të tjera të konkretisht:

1	Bashkia Belsh (0808)	L.T.E CONSTRUCTION	5,963,980	2152001 Bashkia Belsh Ndërtim i tregut Bujqësor - Blegtoral UP nr 2303/1 dt 25.8.22 Njoft.fit nr 2303/9 dt 17.10.22 Kontr.nr.2303/11 dt 01.11.2022 Fat 176/2022 sit.nr 1 dt 09.12.2022 Prok.posacme nr 6547 dt 25.11.2022
2	Bashkia Belsh (0808)	L.T.E CONSTRUCTION	4,740,690	2152001 Bashkia Belsh Ndërtim i tregut Bujqësor - Blegtoral UP nr 2303/1 dt 25.8.22 Njoft.fit nr 2303/9 dt 17.10.22 Kontr.nr.2303/11 dt 01.11.2022 Fat 36/2023 sit.nr 2 dt 23.02.2023 Prok.posacme nr 6547 dt 25.11.2022
3	Bashkia Kamez (3535)	L.T.E CONSTRUCTION	9,153,140	Bashkia Kamez rehabilitim rruga Kozare up nr 7563 dt 26.08.22 njoftimi nr 8851 dt 30.09.2022 kont nr 9268 date 12.10.2022 situ nr 1 dt 17.04.23 fat nr 59/2023 dt 26.04.2023
4	Bashkia Bulqize (0603)	L.T.E CONSTRUCTION	6,653,581	BASHKIA BULQIZE (2103001) likujdim situacion pjesor nr.1 per objektin"1030159 SA i rruges Bllace loti I", up nr.454/1 dt.24.01.2023,kontrate dt.14.04.2023, fature nr.84/2023 dt.04.07.2023.

5	Bashkia Belsh (0808)	L.T.E CONSTRUCTION	10,026,083	2152001 Bashkia Belsh Ndërtim i tregut Bujqësor - Blegtoral UP nr 2303/1 dt 25.8.22 Njoft.fit nr 2303/9 dt 17.10.22 Kontr.nr.2303/11 dt 01.11.2022 Fat 100/2023 sit.perfund. dt 13.09.2023 Akt kolaudim dt 08.8.23 Akt marrje dorez.dt 23.8.2023
6	Bashkia Kamez (3535)	L.T.E CONSTRUCTION	5,000,000	Bashkia Kamez rikonst. rruga Kozare kont vazhd nr 9268 dt 12.10.22 sit nr 1 dt 17.04.23 fat nr 59 dt 26.04.23
7	Komuna Dropull i Poshtem (1111) / Bashkia Dropull (1111)	L.T.E CONSTRUCTION	9,605,450	2452001, Bashkia Dropull. Rikonstruksion i rruges Sofratik-Terihat, fatura nr. 112/2023,dt. 26.10.2023.Situacion punimesh nr 1. Kontrate nr. 667,dt. 20.04.2023.
8	Komuna Dropull i Poshtem (1111) / Bashkia Dropull (1111)	L.T.E CONSTRUCTION	6,316,550	2452001, Bashkia Dropull.Rikonstruksion i rruges Sofratik Terihat,fatura nr. 112/2023,dt.26.10.2023.Situacion nr 1.Kontrate nr. 667prot, dt. 20.04.2023.

Aktualisht shoqëria “L.T.E CONSTRUCTION” shpk:

- nuk ka paraqitur vertetime per shlyerjen e detyrimeve ne Belsh per vitin 2022 dhe 2023, per kontraten 2303/11 te lidhur me Bashkine Belsh ne daten 01.11.2022, me objekt “Ndërtim i tregut Bujqësor – Blegtoral”.
- nuk ka paraqitur vertetime per shlyerjen e detyrimeve ne Kamez per vitin 2022 dhe 2023, per kontraten 9268 te lidhur me Bashkine Belsh ne daten 12.10.2022, me objekt “Rehabilitim rruga Kozare”.
- nuk ka paraqitur vertetime per shlyerjen e detyrimeve ne Bulqize per vitin 2023, per kontraten e lidhur me Bashkine Bulqize ne daten 14.04.2023, me objekt “Rruga Bllace”.
- nuk ka paraqitur vertetime per shlyerjen e detyrimeve ne Dropull per vitin 2023, per kontraten nr. 667 te lidhur me Bashkine Dropull ne daten 20.04.2023, me objekt “Rikonstruksion i rruges Sofratike”.

Autoriteti kontraktor ne percaktimin e kesaj kerkese per kualifikim eshte bazuar ne Ligjin 9723, date 03.05.2007, i ndryshuar “Per Regjistrimin e Biznesit”, konkretisht ne dispozitat ligjore te meposhtme:

Nenin 22 “Detyrimi per Regjistrim”, pika 4 ku citohet:

“Aplikimi per ndryshimin e selise dhe hapja e vendeve te tjera te ushtrimit te veprimtarise behet brenda 30 diteve kalendarike nga data e vendimit perkates, por ne cdo rast, perpara nisjes efektive te veprimtarise ne ate vend”, si dhe Nenin 43 “Regjistrime te tjera te detyrueshme” pika 3/d ku citohet:

“Pervec sa parashikohet ne piken 1 te ketij neni, subjekti duhet te regjistroje dhe te depozitoje aktet perkatese, si me poshte:..... d. Vendet e tjera te ushtrimit te veprimtarise, te ndryshme nga selia”

Ky ligj percakton si detyrim te personit juridik regjistrimin e vendeve e tjera te ushtrimit te veprimtarise. Me vende te tjera te ushtrimit te veprimtarise do te kuptojme ushtrimin e saj ne vende te ndryshme nga selia e personit juridik.

Gjithashtu autoriteti kontraktor eshte bazuar edhe ne nenin 43 te ligjit 9920, date 19.05.2008, i ndryshuar, ”Per Procedurat Tatimore” pika 1/1 ku citohet:

“Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, në çdo rast bëhen përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend. Për hapjen e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me një certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm. Kjo certifikatë lëshohet për të identifikuar vendndodhjen e ushtrimit të veprimtarisë, kur është e ndryshme nga selia.”.

Duke qene se regjistrimi i vendeve te aktivitetit eshte detyrim ligjor, autoriteti kontraktor nuk ka kerkuar vertetime vetem per vendet e regjistruara ne QKB, por ne gjithë vendet ku operatori ekonomik ushtron aktivitet edhe nese, ne menyre te kundraligjshme, nuk ben regjistrimin ne QKB. Nisur nga sa me siper, shoqeria “L.T.E CONSTRUCTION” shpk nuk e ploteson kete kerkese per kualifikim.

Shoqeria “C O L O M B O” shpk me NUIS J82916489E nuk ploteson kerkesen 2.3.3.b te kerkesave te vecanta per kualifikim ku kerkohet:

b. *Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë staf teknik dhe punonjës të specializuar/të kualifikuar, te pa angazhuar ne kontratat qe operatori ekonomik ka ne vijim me autoritete te tjere kontraktore, minimalisht si më poshtë :*

- Hidraulikë 2 (dy)
- Elektricistë 2 (dy)
- Instalues dhe riparues të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse 2 (dy)
- Hekurkthyes 2 (dy)
- Karpentier 2 (dy)
- Betonues dhe të tjerë që lidhen me to 4 (kater)
- Hidroizolues 2 (dy)
- Specialist gipsi 3 (tre)
- Muratorë 4 (kater)
- Suvatues 3 (tre)
- Bojaxhi 4 (katër)
- Punonjës duro-alumini 2 (dy)
- Shtrues pllakash dhe të tjerë që lidhen me to 4 (katër)

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin:

- kontratën individuale të punës;
- Deklaratën e nenshkruar nga administratori apo personi i autorizuar ne forme tabele me të dhënat si më poshtë :

DEKLARATE

Deklaroj se shoqeria _____ disponon staf teknik dhe punonjës të specializuar/të kualifikuar, te pa angazhuar ne kontratat kemi ne vijim me autoritete te tjere kontraktore, si më poshtë :

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni
1		
2		
etj		

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Ne piken 3, te nenit 88 “Bashkimi i Operatoreve Ekonomike” te VKM nr. 285, date 19,05,2021, “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” kerkohet:

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Shoqeria “C O L O M B O” shpk ka deklaruar ne formularin permbledhes te vetedeklarimit se ka te punesuar dy specialiste betonues nga kater te kerkuar ne kerkesen per kualifikim nderkohe qe ka marre persiper te kryeje 68% te vleres se punimeve. Duke qene se jo te gjithe volume e punimeve do te zbatohen ne raportin 68% shoqeria “Colombo” shpk dhe 32% shoqeria “L.T.E Construction” shpk, Personi i ngarkuar me shqyrtimin e ankeses verifikoi volumin e betonit te parashikuar per tu hedhur ne objekt dhe sasine perkatese per secilen shoqeri. Rezultatet permbliidhen ne tabelen ne vijim:

Nr	analiza	Emertimi Punimeve	Njesia	Sasia	LTE CONSTRUCTION	COLOMBO
4	2.262/3	Nenshtresa beton C-12/15	m ³	5.0	1.0	4.00
5	2.262/4b	Pllake themeli, beton C-25/30	m ³	30.0	7.0	23.00
6	analiza	Beton arme C-30/37 per mure	m ³	20.0	5.0	15.00
7	analiza	Beton arme C-30/37 per kollona	m ³	25.0	6.0	19.00
8	analiza	Beton arme C-30/37 per trare	m ³	51.0	12.0	39.00
9	analiza	Beton arme C-30/37 per soleta + shkalle	m ³	179.0	44.0	135.00
3	2.121/1	Brez brez beton arme C-16/20	m ³	4.8	1.0	4.00
7	analize	Shtrese betoni i lehtesuar per pjeresi t = mes 8cm	m ³	32.4	8.0	24.00
1	analize	Shtrese betoni i lehtesuar t = mes 6 cm, sipa V.T.	m ³	22.0	5.0	17.00
6	analize	Shtrese betoni i lehtesuar per pjeresi t = mes 8cm	m ³	2.0	0.0	2.00
SASITE TOTALE				371.2	89.0	282.0
SASITE NE %					24%	76%

Nga tabela rezulton se shoqeria “C O L O M B O” shpk ka marre persiper te kryeje 76% te punimeve te betonit nderkohe qe ka ne dispozicion vetem 2 specialiste ose 50% te stafit minimal te domosdoshem. Ne kete menyre kjo shoqeri nuk e ploteson kete kusht per kualifikim.

Shoqeria “C O L O M B O” shpk me NUIS J82916489E nuk ploteson kerkesen 2.3.4 te kerkesave te vecanta per kualifikim ku kerkohet:

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës, te pa angazhuara ne kontratat qe operatori ekonomik ka ne vijim me autoritete te tjere kontraktore:

Nr.	Mjete/pajisje teknike	Sasia	Gjendja
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton	2 copë	Në pronësi ose me qera
2	Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton	2 copë	Në pronësi ose me qera
3	Ekskavator me goma	1 copë	Në pronësi ose me qera
4	Minieskavator	1 copë	Në pronësi ose me qera
5	Autobetoniere	2 copë	Në pronësi ose me qera
6	Pompë suvatimi	1 copë	Në pronësi ose me qera
7	Autovinç	1 copë	Në pronësi ose me qera
8	Vibrator betoni	3 copë	Në pronësi ose me qera
9	Betoniere kantieri	1 copë	Në pronësi ose me qera
10	Tranxhe për perpunimin e hekurit te ndertimit	1 copë	Në pronësi ose me qera
11	Autopompe betoni	1 copë	Në pronësi ose me qera

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtëm :

Për mjetet që janë në pronësi, duhet të paraqitet :

- dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
- dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik ;
- siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Kur janë me qera, duhet të paraqitet :

- kontrata e qerasë;
- dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik ;
- siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Për mjetet apo pajisjet e tjera që nuk pajisen me leje qarkullimi, ofertuesi duhet të paraqesë kontratë noteriale të blerjes ose fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimi të mjetit dhe foto të tyre.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Ne piken 3, te nenit 88 “Bashkimi i Operatoreve Ekonomike” te VKM nr. 285, date 19,05,2021, “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” kerkohet:

- Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Shoqeria “C O L O M B O” shpk nuk ka deklaruar ne formularin permbledhes te vetedeklarimit se disponon mjetin e kerkuar “Autopompe betoni” nderkohe qe rezulton se

shoqeria “C O L O M B O” shpk ka marre persiper te kryeje 76% te punimeve te betonit. Ne kete menyre kjo shoqeri nuk e ploteson kete kusht per kualifikim.

Shoqeria “C O L O M B O” shpk me NUIS J82916489E nuk ploteson kerkesen 2.3.4 te kerkesave te vecanta per kualifikim ku kerkohet:

2.3.7 *Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe të mjedisit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme:*

- *Certifikatë ISO 9001:2015 ose ekuivalente mbi “Sistemet e menaxhimit te cilësisë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;*
- *Certifikatë ISO 45001 - 2018 ose ekuivalente mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim;*
- *Çertifikatë ISO 14001:2015 ose ekuivalente mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim.*

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Kjo shoqeri ka paraqitur certifikata ISO te leshuara nga shoqeria “Rigcert” nderkohe qe kjo shoqeri nuk eshte e akredituar per leshimin e ketyre certifikatave nga organizmi kombetar i akreditimit apo organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Ky fakt u verifikua ne faqen online <https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/> . Ne kete menyre kjo shoqeri nuk e ploteson kete kusht per kualifikim.

Bashkimi i Operatoreve Ekonomike nuk ka plotesuar sakte preventivin e dhene ne dokumentat e tenderit, ne kundershtim me piken 4, te germes “B” te seksionit 1 te DST “Udhezime per operatoret ekonomike” ku citohet:

- 1. Formularët e tenderit dhe preventivat Çmimeve** e Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqëruar duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar.

Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme dhe të printuar duhet të pajisen me inicialet ose të nënshkruhen nga Personi (at) e Autorizuar. Çdo ndryshim në ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i nënshkruar nga Personat e Autorizuar.

Ne preventivin e punimeve, ne kapitullin 3. “Sistemi i sinjalizimit te zjarrit” BOE nuk ka plotesuar cmimin per zerin 7 “Fv perserites optik me drite per sensore brenda tavanit” duke

beret e pamundur vleresimin objektiv te ofertes. Ne kete menyre ky BOE nuk e ploteson kete kusht per kualifikim.

Bashkimi i Operatoreve Ekonomike nuk ploteson kerkesen 2.3.6 te kerkesave te vecanta per kualifikim ku kerkohet:

2.3.6 *Operatorët ekonomikë, për artikujt/pajisjet e cilësuar në tabelen e mesiperme, duhet të paraqesin katalogë ose broshura me të dhënat teknike. Në katalog, të markohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secili nga artikujt/pajisjet që oferton sipas modelit të deklaruar dhe të markohen edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me katalogun e paisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmerine e tyre. Ne kataloge do te markohet vetem nje paisje per secilin artikull.*

Pasi:

Per artikullin nr. 6 “Gjenerator diesel $S = 45 \text{ kVA} / , U_n = 400V$, silencioze, deri 60db per 7m, komplet me kuadrin automatik dhe gjithcka te nevojshme sipas standartit” nuk gjendet ne katalog specifikimi lidhur me zhurmen deri 60 db per distancen 7 metra.

Per artikullin nr. 10 “Njesi e jashtme-Kompresor inverter VRF (Kompresor me pompe nxehtesie VRF). Kapaciteti ftohes / ngrohes ne temperaturen $0.0^{\circ}\text{C} : 73 / 81 \text{ kW}$. Fuqia elektrike / tensioni /ushqimi : Ftohje: 19 kW /Ngrohje: $16.3 \text{ kW} / 380-415V / 3 F \sim 50\text{Hz}$. Pesha 585 kg ” kataloget e paraqitur jane krejtesisht te palexueshem dhe, ne kete menyre, nuk mund te gjykohet per plotesimin e specifikimeve teknike.

Per artikullin nr. 11 “Njesi e jashtme-Kompresor inverter VRF (Kompresor me pompe nxehtesie VRF). Kapaciteti ftohes / ngrohes ne temperature $0.0^{\circ}\text{C} : 106.5 / 119 \text{ kW}$. Fuqia elektrike / tensioni /ushqimi : Ftohje: 42 kW /Ngrohje: $29.7 \text{ kW} / 380-415V / 3 F \sim 50\text{Hz}$. Pesha 745 kg ” kataloget e paraqitur jane krejtesisht te palexueshem dhe, ne kete menyre, nuk mund te gjykohet per plotesimin e specifikimeve teknike.

Per artikullin nr. 12 “Njesi Rekuperatore Ajri Volumi i ajrit max : $2950 \text{ m}^3/\text{h}$ Presioni statik 150 Pa Fel.e vetilatoreve $2 \times 0.54 \text{ kW}$ $1F \sim 230V, 50\text{Hz}$ Kapaciteti termik ftohje: 22.0 kW Kapaciteti termik ngrohje: 25.0 kW Kapaciteti i rekuperimit: 66.9% ” nuk ploteson specifikimin lidhur me kapacitetin e kerkuar te rekuperimit i cili, sipas specifikimit, duhet te jete 66.9% nderkohe qe sipas katalogut eshte $51.8\% - 57.4\%$

Per artikullin nr. 13 “Njesi Rekuperatore Ajri Volumi i ajrit max : $3900 \text{ m}^3/\text{h}$ Presioni statik 150 Pa Fel.e vetilatoreve $2 \times 0.87 \text{ kW}$ $1F \sim 230V, 50\text{Hz}$ Kapaciteti termik ftohje: 28.0 kW Kapaciteti termik ngrohje: 31.5 kW Kapaciteti i rekuperimit: 62.7% ” nuk ploteson specifikimin lidhur me kapacitetin e kerkuar te rekuperimit i cili, sipas specifikimit, duhet te jete 62.7% nderkohe qe sipas katalogut eshte $51.4\% - 56.9\%$.

Per artikullin nr. 14 “Njesi e brendshme VRF me zgjerim direkt - Kanalor, kapaciteti ne ftohje/ngrohje $14.00 / 16.00 \text{ kW}$, prurja maksimale e ajrit $V_{mx} = 2000 \text{ m}^3/\text{h}$, furnizimi elektrik $1F \sim 230V \sim 50\text{Hz}$ ” kataloget e paraqitur jane krejtesisht te palexueshem dhe, ne kete menyre, nuk mund te gjykohet per plotesimin e specifikimeve teknike.

Per artikullin nr. 15 “Njesi e brendshme VRF me zgjerim direkt - Murale, kapaciteti ne ftohje/ngrohje 2.80/3.20 kW, prurja maksimale e ajrit $V_{mx}=500\text{ m}^3/\text{h}$, furnizimi elektrik $1F\sim 230V\sim 50Hz$.” kataloget e paraqitur jane krejtesisht te palexueshem dhe, ne kete menyre, nuk mund te gjykohe per plotesimin e specifikimeve teknike.

Per artikullin nr. 16 “Njesi e brendshme VRF me zgjerim direkt - Dysheme, kapaciteti ne ftohje/ngrohje 5.00/5.50 kW, prurja maksimale e ajrit $V_{mx}=680\text{ m}^3/\text{h}$, furnizimi elektrik $1F\sim 230V\sim 50Hz$.” kataloget e paraqitur jane krejtesisht te palexueshem dhe, ne kete menyre, nuk mund te gjykohe per plotesimin e specifikimeve teknike.

Personi i ngarkuar me shqyrtimin e ankeses gjykon se eshte detyre e Operatoreve Ekonomike te sigurohen qe materialet e ngarkuar ne sistem te jene qartesisht te lexueshem.

2. OPERATORI EKONOMIK “LEON KONSTRUKSION” SHPK ME NUIS K71820009I:

Operatori Ekonomik “Leon Konstruksion” shpk, me NUIS K71820009I, nuk ploteson kerkesen 2.3.6 te kerkesave te vecanta per kualifikim ku kerkohet:

2.3.6 *Operatorët ekonomikë, për artikujt/pajisjet e cilësuar në tabelen e mesiperme, duhet të paraqesin katalogë ose broshura me të dhënat teknike. Në katalog, të markohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secili nga artikujt/pajisjet që oferton sipas modelit të deklaruar dhe të markohen edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me katalogun e paisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmerine e tyre. Ne kataloge do te markohet vetem nje paisje per secilin artikull.*

Pasi:

Per artikullin nr. 4 “Kamera te brendshme, IR Dome kamera 3MP 2.8mm, 3MP high resolution, HD real-time video, 3D DNR & DWDR & BLC, IR LEDs: up to 30m, IP66, Vandal-proof, PoE” kataloget e paraqitur jane krejtesisht te palexueshem dhe, ne kete menyre, nuk mund te gjykohe per plotesimin e specifikimeve teknike.

Per artikullin nr. 5 “Kamera te jashtme, IR Bullet kamera 3MP, VF Lens 2,8-12 mm, 3 megapixel high resolution, HD video output, Low illumination, 3D DNR & DWDR & BLC, IP66 rating, IR range: up to 30m, True day / night, POE interface” kataloget e paraqitur jane krejtesisht te palexueshem dhe, ne kete menyre, nuk mund te gjykohe per plotesimin e specifikimeve teknike.

Per artikullin nr. 6 “Gjenerator diesel $S = 45\text{ kVA}$ / , $U_n = 400V$, silencioze, deri 60db per 7m, komplet me kuadrin automatik dhe gjithcka te nevojshme sipas standartit” nuk gjendet ne katalog specifikimi lidhur me zhurmen deri 60 db per distancen 7 metra.

Per artikullin nr. 7 “U.P.S. 15 KVA, 3 fazor 10 min, auotonomi” ne katalog paraqiten 4 tipe ups nen emertimin “Online double conversion technology 3 phase in 3 phase out 10 kva to 30 kva”:

FOL 10T-3/3

FOL 15T-3/3

FOL 20T-3/3

FOL 30T-3/3

Operatori ekonomik nuk ka markuar asnje prej tyre dhe, ne kete menyre, nuk mund te gjykohe per plotesimin e specifikimeve teknike.

Per artikullin nr. 9 “Grupi i furnizimit me uje sanitar me 2 pompa Horizontale ON/OFF te lidhura ne paralel: Prurja = 5.7 m³/h (per secilen pompe); H = 30 m; 3x400V; 5.2 A; Lidhjet: 2”; Kolektore celik inox/galvanizuar;

Ene zgjerimi 25 litra” ne katalogun e paraqitur mungojne specifikimet per enen e zgjerimit me volum 25 litra.

Per artikullin nr. 10 “Njesi e jashtme-Kompresor inverter VRF (Kompresor me pompe nxehtesie VRF). Kapaciteti ftohes / ngrohjes ne temperaturen 0.0°C : 73 / 81 kW. Fuqia elektrike / tensioni /ushqimi : Ftohje: 19 kW/Ngrohje: 16.3 kW/ 380-415V/ 3 F ~ 50Hz . Pesha 585 kg” kataloget e paraqitur jane gati te palexueshem. Nen emertimin “Paisje e jashtme VRF Cooper & Hunter...” paraqiten shume tipe paisjesh. Operatori ekonomik nuk ka markuar asnje prej tyre dhe, ne kete menyre, nuk mund te gjykohe per plotesimin e specifikimeve teknike.

Per artikullin nr. 11 “Njesi e jashtme-Kompresor inverter VRF (Kompresor me pompe nxehtesie VRF). Kapaciteti ftohes / ngrohjes ne temperature 0.0°C : 106.5 / 119 kW. Fuqia elektrike / tensioni /ushqimi : Ftohje: 42 kW/Ngrohje: 29.7 kW/ 380-415V/ 3 F ~ 50Hz. Pesha 745 kg” kataloget e paraqitur jane gati te palexueshem. Nen emertimin “Paisje e jashtme VRF Cooper & Hunter...” paraqiten shume tipe paisjesh. Operatori ekonomik nuk ka markuar asnje prej tyre dhe, ne kete menyre, nuk mund te gjykohe per plotesimin e specifikimeve teknike.

Per artikullin nr. 12 “Njesi Rekuperatore Ajri Volumi i ajrit max : 2950 m³/h Presioni statik 150 Pa Fel.e ventilatoreve 2x0.54 kW 1F~230V,50Hz Kapaciteti termik ftohje: 22.0 kW Kapaciteti termik ngrohje: 25.0 kW Kapaciteti i rekuperimit: 66.9 %” nuk ploteson specifikimin lidhur me kapacitetin e kerkuar te rekuperimit i cili, sipas specifikimit, duhet te jete 66.9% nderkohe qe sipas katalogut eshte 51.8% – 57.4%

Per artikullin nr. 13 “Njesi Rekuperatore Ajri Volumi i ajrit max : 3900 m³/h Presioni statik 150 Pa Fel.e ventilatoreve 2x0.87 kW 1F~230V,50Hz Kapaciteti termik ftohje: 28.0 kW Kapaciteti termik ngrohje:31.5 kW Kapaciteti i rekuperimit: 62.7 %” nuk ploteson specifikimin lidhur me kapacitetin e kerkuar te rekuperimit i cili, sipas specifikimit, duhet te jete 62.7% nderkohe qe sipas katalogut eshte 51.4% – 56.9%

Per artikullin nr. 14 “Njesi e brendshme VRF me zgjerim direkt - Kanalor, kapaciteti ne ftohje/ngrohje 14.00 /16.00 kW, prurja maksimale e ajrit Vmx.=2000 m³/h, furnizimi elektrik 1F~230V~50Hz” kataloget e paraqitur jane gati te palexueshem. Ne kataloge paraqiten shume tipe paisjesh. Operatori ekonomik nuk ka markuar asnje prej tyre dhe, ne kete menyre, nuk mund te gjykohe per plotesimin e specifikimeve teknike.

Per artikullin nr. 15 “Njesi e brendshme VRF me zgjerim direkt - Murale, kapaciteti ne ftohje/ngrohje 2.80/3.20 kW, prurja maksimale e ajrit Vmx.=500 m³/h, furnizimi elektrik 1F~230V~50Hz.” kataloget e paraqitur jane gati te palexueshem. Ne kataloge paraqiten shume tipe paisjesh. Operatori ekonomik nuk ka markuar asnje prej tyre dhe, ne kete menyre, nuk mund te gjykohe per plotesimin e specifikimeve teknike.

Per artikullin nr. 16 “Njesi e brendshme VRF me zgjerim direkt - Dysheme, kapaciteti ne ftohje/ngrohje 5.00/5.50 kW, prurja maksimale e ajrit Vmx.=680 m³/h, furnizimi elektrik 1F~230V~50Hz” kataloget e paraqitur jane gati te palexueshem. Ne kataloge paraqiten shume tipe

paisjesh. Operatori ekonomik nuk ka markuar asnje prej tyre dhe, ne kete menyre, nuk mund te gjykohe per plotesimin e specifikimeve teknike.

3. OPERATORI EKONOMIK “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” SHPK ME NUIS K82230002K:

Operatori Ekonomik “Eral Construction Company” shpk me NUIS K82230002K, nuk ploteson kerkesen 2.3.6 te kerkesave te vecanta per kualifikim ku kerkohet:

2.3.6 *Operatorët ekonomikë, për artikujt/pajisjet e cilësuar në tabelen e mesiperme, duhet të paraqesin katalogë ose broshura me të dhënat teknike. Në katalog, të markohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secili nga artikujt/pajisjet që oferton sipas modelit të deklaruar dhe të markohen edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me katalogun e paisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmerine e tyre. Ne kataloge do te markohet vetem nje paisje per secilin artikull.*

Pasi:

Per artikullin nr. 6 “Gjenerator diesel $S = 45 \text{ kVA} / , Un = 400V$, silencioze, deri 60db per 7m, komplet me kuadrin automatik dhe gjithcka te nevojshme sipas standartit” nuk gjendet ne katalog specifikimi lidhur me zhurmen e cila sipas specifikimeve teknike nuk duhet te kaloje vleren 60 db per distancen 7 metra. Ne katalog specifikohet qe gjeneratori respekton direktiven EU Directive 2000/14/EC, amenduar me directive Directive 2005/88/EC. Referuar kesaj direktive, per nje gjenerator me fuqi 45 kva niveli maksimal i lejuar i zhurmes ne distancen 7 metra eshte 85 db, me i larte se niveli i kerkuar sipas specifikimeve teknike.

Per artikullin nr. 8 “Grupi i MNZ sipas EN12845 i perbere nga 2 Pompa elektrike 2x4.5 kW (1 ne pune + 1 ne stand-by) ku secila jep: $Q=4.2 \text{ m}^3/h$; $H=35 \text{ mkH}_2\text{O}$; Pompe Pilot "Jockey" 1x0.65 kW, Hydro EN-S2 32-200/219 - 98925936 Grupi i MNZ kompletuar me Panel Komandimi dhe Presostate per secilen pompe. Ene zgjerimi 24 lit per pompen pilot. Xhunto antivibrante, valvola flutur DN50, kolektor dergimi, valvola mos-kthimi DN50” Ne katalog nuk gjendet asnje e dhene lidhur me volumin e enes se zgjerimit qe sipas specifikimeve teknike duhet te kete nje volum 24 litra. Nuk ka asnje te dhene per xhunton antivibrante, valvolen flutut DN50 dhe valvolen e moskthimit DN50.

Per artikullin nr. 9 “Grupi i furnizimit me uje sanitar me 2 pompa Horizontale ON/OFF te lidhura ne paralel: Prurja = $5.7 \text{ m}^3/h$ (per secilen pompe); $H = 30 \text{ m}$; $3 \times 400V$; 5.2 A ; Lidhjet: 2”; Kolektore çelik inox/galvanizuar; Ene zgjerimi 25 litra” ne katalog nuk gjendet asnje e dhene lidhur me volumin e enes se zgjerimit qe sipas specifikimeve teknike duhet te kete nje volum 25 litra.

Per artikullin nr. 10 “Njesi e jashtme-Kompresor inverter VRF (Kompresor me pompe nxehtesie VRF). Kapaciteti ftohes / ngrohjes ne temperaturen 0.0°C : 73 / 81 kW. Fuqia elektrike / tensioni / ushqimi : Ftohje: 19 kW/Ngrohje: 16.3 kW/ 380-415V / 3 F ~ 50Hz . Pesha 585 kg” kataloget e paraqitur jane krejtesisht te palexueshem dhe, ne kete menyre, nuk mund te gjykohe per plotesimin e specifikimeve teknike.

Nga verifikimi ne faqen

<http://midea.com.ge/uploads/client/Uploads/Catalogues/Service%20Manuals/VRF%20V6%20Engineering%20Data%20Book%20-%20Europe.pdf> rezulton se nuk ploteson kerkesat pasi kapaciteti ftohes/ngrohjes eshte 73/73 kw nga 73/81 kw te kerkuara.

Per artikullin nr. 11 “Njesi e jashtme-Kompresor inverter VRF (Kompresor me pompe nxehtesie VRF). Kapaciteti ftohes / ngrohjes ne temperature 0.0°C : 106.5 / 119 kW. Fuqia elektrike / tensioni /ushqimi : Ftohje: 42 kW/Ngrohje: 29.7 kW/ 380-415V / 3 F ~ 50Hz. Pesha 745 kg” kataloget e paraqitur jane krejtesisht te palexueshem dhe, ne kete menyre, nuk mund te gjykohej per plotesimin e specifikimeve teknike. Nga verifikimi ne faqen <http://midea.com.ge/uploads/client/Uploads/Catalogues/Service%20Manuals/VRF%20V6%20Engineering%20Data%20Book%20-%20Europe.pdf> rezulton se nuk ploteson kerkesat pasi kapaciteti ftohes/ngrohjes eshte 106.5/106.5 kw nga 106,5/119 kw te kerkuara.

Per artikullin nr. 12 “Njesi Rekuperatore Ajri Volumi i ajrit max : 2950 m³/h Presioni statik 150 Pa Fel.e vetilatoreve 2x0.54 kW 1F~230V,50Hz Kapaciteti termik ftohje: 22.0 kW Kapaciteti termik ngrohje: 25.0 kW Kapaciteti i rekuperimit: 66.9 %” nuk ploteson specifikimet teknike pasi kapaciteti i rekuperimit eshte 54% nga 66.9% qe eshte kerkuar ne specifikimet teknike.

Per artikullin nr. 13 “Njesi Rekuperatore Ajri Volumi i ajrit max : 3900 m³/h Presioni statik 150 Pa Fel.e vetilatoreve 2x0.87 kW 1F~230V,50Hz Kapaciteti termik ftohje: 28.0 kW Kapaciteti termik ngrohje:31.5 kW Kapaciteti i rekuperimit: 62.7 %” nuk ploteson specifikimet teknike pasi kapaciteti i rekuperimit eshte 55% nga 62.7% qe eshte kerkuar ne specifikimet teknike.

Per artikullin nr. 14 “Njesi e brendshme VRF me zgjerim direkt - Kanalor, kapaciteti ne ftohje/ngrohje 14.00 /16.00 kW, prurja maksimale e ajrit Vmx.=2000 m³/h, furnizimi elektrik 1F~230V~50Hz” kataloget e paraqitur jane krejtesisht te palexueshem dhe, ne kete menyre, nuk mund te gjykohej per plotesimin e specifikimeve teknike.

Per artikullin nr. 15 “Njesi e brendshme VRF me zgjerim direkt - Murale, kapaciteti ne ftohje/ngrohje 2.80/3.20 kW, prurja maksimale e ajrit Vmx.=500 m³/h, furnizimi elektrik 1F~230V~50Hz.” kataloget e paraqitur jane krejtesisht te palexueshem dhe, ne kete menyre, nuk mund te gjykohej per plotesimin e specifikimeve teknike.

Per artikullin nr. 16 “Njesi e brendshme VRF me zgjerim direkt - Dysheme, kapaciteti ne ftohje/ngrohje 5.00/5.50 kW, prurja maksimale e ajrit Vmx.=680 m³/h, furnizimi elektrik 1F~230V~50Hz” kataloget e paraqitur jane krejtesisht te palexueshem dhe, ne kete menyre, nuk mund te gjykohej per plotesimin e specifikimeve teknike.

4. OPERATORI EKONOMIK "AGRI CONSTRUCTION" SHPK ME NUIS K01725001F:

Bazuar në vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik (KPP) me nr. 364/2024 protokolluar me nr. 471/8 prot., date 09.04.2024 mbi ankesën e operatorit ekonomik "AGRI CONSTRUCTION" SHPK.

Sipas kriterit 2.3.6 Operatorët ekonomikë, për artikujt/pajisjet e cilësuar në tabelën, duhet të paraqesin katalogë ose broshura me të dhënat teknike. Në katalog, të markohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secili nga artikujt/pajisjet që oferton sipas modelit të deklaruar dhe të markohen edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të ofertuar do të

krahasohen me katalogun e paisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmerine e tyre. Në katalogë do të markohet vetëm një paisje për secilin artikull.

Prurja maksimale e ajrit Vmx 680 furnizimi elektrik IF-230V-50H Tabela

Në dokumentet e tenderit, si pjesë përbërëse e projektit të zbatimit, autoriteti kontraktor

-Relacioni teknik në pdf. -Specifikime teknike në pdf.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik "AGRI CONSTRUCTION" sh.p.k, rezulton, se ka paraqitur në SPE, në përmbushje të kriterit të sipërcituar,

-Dokumentin me emërtimin EURO_AD_(Q=6.182_H=50.62);

Bazuar në nenin 2 “Qëllimi”, neni 3 “Parime të përgjithshme”, neni 77 , neni 92 të ligjit nr.162/22 “Për prokurimin publik” si dhe nenit 40 pika 6 dhe 8 të VKM-së me nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar për kriteret 2.3.5 dhe 2.3.6

Nga shqyrtimi dokumentacionit të procedurës së ankimmuar, të administruar prane si dhe bazuar në pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, konstatohet se në pikën **2.3.6** të dokumenteve të tenderit si dhe në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit Subjekt për ankim i është kërkuar që, Operatorët ekonomike, për artikujt pajisjet te cilësuar në tabelen prezente sipas kriterit në pikën **2.3.5**, duhet të paraqesin katalogë ose broshura me të dhënat teknike Në katalog, të markohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secili nga artikujt/pajisjet që oferton sipax modelit të deklaruar dhe të markohen edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me katalogun e paisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmerine e tyre. Ne kataloge do te markohet vetem nje paisje per secilin artikull. Nga verifikimi i dokumenteve të operatorit ekonomik "AGRI CONSTRUCTION" SHPK, konstatohet, se dokumentet me emërtimin "Deklaratë për pajisjet" dhe "EURO AD (Q-6.182_H=50.62)", të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, janë një deklaratë e ofertuesit për modelin, kompaninë prodhuese, vendimin e prodhimit për mallrat e pajisjet që do të vendosen në objekt sipas tabelës së kërkuar në pikën 2.3.5., si dhe katalogun (broshura në gjuhë të huaj angleze), për pajisjen nr.9 Grupi i furnizimit me ujë sanitar me 2 pompa.

Referuar kriterit 2.3.6 dhe 2.3.5., operatorët ekonomikë duhet që për të gjitha pajisjet e listuara në tabelën e kërkuar në pikën 2.3.5, të deklarojnë paraqesin katalogët ku të evidentohet plotësimi i specifikimeve teknike. Tabela është e detyrueshme për t'u plotësuar për të gjithë artikujt e listuar. Mosplotësimi i kësaj table është kusht skualifikues. Katalogu të përmbajë

karakteristikat teknike të çdo artikulli, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe konkretisht:

Pajisja nr. 9. Grupi i furnizimit me ujë sanitar me 2 pompa

Horizontale-ON/OFF të lidhura në paralel:

Prurja 5.7 m³/h (për secilën pompë); H = 30 m;

3x400V; 5.2 A; Lidhjet: 2"; Kolektore çelik

inox/galvanizuar:

Ene zgjerimi 25 litra;

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga ana e ankimuesit, nuk evidentohet të jetë dorëzuar ndonjë katalog/broshurë/skede teknike mbi enën e zgjerimit 25 litra. Gjithashtu, vetë ankimuesi në formularin e ankesës ka cituar se "ena e zgjerimit është një pajisje e

thjeshtë dhe nuk vendoset në katalogët e pompave pasi për të njëjtin tip pompe, në varësi të konsumit, mund të vendosen enë zgjerimi me kapacitet të ndryshëm", duke pranuar vetë, që nuk ka dorëzuar asnjë dokument të llojit katalog/broshurë/skede teknike për enën e zgjerimit 25 litra. Ndërkohë, nga dokumentacioni i paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni konstaton, se nuk ka paraqitur asnjë dokument tjetër provues për plotësimin e këtij kriteri. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor, me të drejtë ka skualifikuar operatorin ekonomik ankimues, pasi dokumenti i paraqitur prej tij, nuk është në përputhje me plotësimin e kriterit 2.3.6 dhe të kërkesave të tabelës në pikën 2.3.5 të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

Komisioni thekson, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Në rastin konkret, Komisioni referuar dokumenteve me emërtimin "Deklaratë_për pajisjet" dhe "EURO_AD (Q-6.182_H=50.62)", të paraqitura nga operatori ekonomik ankimues, për këtë procedurë prokurimi, gjykon, se nuk mund të konsiderohen se përmbushin kërkesat sipas kriterëve në pikat 2.3.6 dhe 2.3.5, të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Në pikën 2.3.5. të Kërkesave të veçanta të kualifikimit kërkohet: 2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet që për të gjithë pajisjet e listuara në tabelën e mëposhtme, të deklarojnë/paraqesin katalogët ku të evidentohet plotësimi i specifikimeve teknike..."

Bazuar në nenin 2 "Qëllimi", neni 3 "Parime të përgjithshme", neni 77 , neni 92 të ligjit nr.162/22 "Për prokurimin publik" si dhe nenet 24, 40 pika 6 dhe 8 të VKM-së me nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar

Në dokumentet e tenderit, Seksioni IV Procedura, pika 4.7 është përcaktuar shprehimisht:

4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:

Shqip

X

Gjithshtu, në Shtojcën 7 të dokumentave të tenderit (shtojca -1), "Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit", përcaktohet shprehimisht se: "Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip".

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se katalogët e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues nuk janë paraqitur në gjuhën shqipe, duke e bërë të pamundur identifikimin e plotësimin të specifikimeve teknike sipas përcaktimeve të autoritetit kontraktor në dokumentet e tenderit, për më tepër që nuk janë të përkthyer të paktën vetëm ato pjesë të katalogut që kanë të bëjnë me përshkrimin apo specifikimet teknike të mallit apo-produktit të kërkuar, pasi katalogu nuk përmban vetëm të dhëna teknike (si përmasa etj.), por edhe përshkrim të produktit. Përcaktimi i bërë në dokumentet e tenderit, si në seksionin IV, ashtu edhe në Shtojcën 7 Kriteret e përgjithshme të kualifikimit, aq më tepër në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik", i ndryshuar, përkufizon qartë që gjuha e përdorur është gjuha shqipe dhe rrjedhimisht çdo dokument i paraqitur në gjuhë të huaj duhet të jetë në gjuhën shqipe, ose i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe, përcaktim ky që vlen për çdo dokument të paraqitur në këtë procedurë prokurimi. Sqarohet se përkufizimi ligjor i mësipërm është gjithëpërfshirës, pra për të gjithë dokumentacionin përkatës që paraqitet në këtë procedurë prokurimi.

Në kushtet kur, në dokumentet e tenderit të hartuara e të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, e konkretisht në kriteret e përgjithshme, të cilat janë detyrues për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë, si dhe detyrues për të mos u ndryshuar nga autoriteti kontraktor gjatë hartimit të dokumentave të tenderit, është përcaktuar qartë e saktë që "Nëse gjuha e përdorur në procedurë është shqip, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe", si edhe gjuha e përdorur është përcaktuar "Gjuha Shqipe", atëherë i gjithë dokumentacioni i paraqitur në procedurën e prokurimit duhet të jetë në gjuhën shqipe ose i përkthyer i noterizuar në gjuhën shqipe. Përcaktim ky gjithëpërfshirës që i përket çdo lloj dokumentacioni që do të paraqitet në këtë procedurë prokurimi nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Akoma më tej, nisur nga përcaktimi i bërë në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit (tek të cilat autoriteti kontraktor mund të përcaktojë vetë kriteret që mendon se janë të nevojshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë të interesuar, gjithnjë në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën e kontratës, objekt prokurimi), përcaktohet qartë që në Shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit (shtojca -1), "Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit", përcaktohet shprehimisht se: "Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip. Ndërkohë që edhe ligjvënësi e ka përcaktuar dhe e ka sqaruar mjaft qartë momentin dhe mënyrën e paraqitjes së dokumentacionit në një procedurë prokurimi, për sa i përket gjuhës së përdorur.

Referuar seksionit II të dokumenteve të tenderit "Udhëzime për operatorët ekonomikë" ku përcaktohet se: "Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do (të refuzohen si të papranueshme", Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e ankimuesit nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në këto dokumente, pasi ankimuesi është i detyruar të plotësojë çdo kërkesë dhe kriter të vendosur nga autoriteti kontraktor, të paraqesë çdo dokumentacion që përmban të dhëna dhe elemente që janë gjykuar të nevojshme dhe të domosdoshme nga ana e këtij të fundit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, makineritë, pajisjet dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik duhet të dorëzojë të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm. Bazuar në sa më sipër, KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me lex specialis. Për sa më sipër, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik "AGRI CONSTRUCTION" ShPK në këtë procedurë prokurimi, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Rrjedhimisht përsa më sipërcituar nga trajtimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr.364/2024 protokolluar me nr.471/8 prot., date 09.04.2024 ku pretendimet e operatorit ekonomik "AGRI CONSTRUCTION" ShPK nuk qëndrojnë.

5. OPERATORI EKONOMIK "INERTI" SHPK ME NUIS J66926804L:

Në lidhje me pretendimet e ankimuesit, Komisioni i Prokurimit Publik vendosi: për pajisjen nr. 8 Grupi MNZ.

Në lidhje me pretendimin e pare te ankimuesit, mbi mosspecifikimin nga ana e ofertuesit për mënyrën e vendosjes apo pozicionimit që zënë këto pompa në Grupin MNZ, si edhe paqartësi mbi mënyrën se si lidhen keto pjesë KPP sqaron, se duke iu referuar hartimit dhe përmbushjes së ketij kriterit, autoriteti kontraktor për rastin konkret, nuk ka kërkuar asnjë skemë lidhëse mbi vendosjen apo pozicionimin që zënë këto pompa anë Grupin MNZ. Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se skualifikimi operatorit ekonomik ofertues është bërë duke ju referuar një kriteri kualifikues të pakërkuar, çka nuk është në përputhje me ligjin për prokurimin publik. KPP gjykon, se nëse autoriteti kontraktor do të kishte paqartësi në vlerësimin për përmbushjen e këtij kriteri, në kuptim të pikës 1, të nenit 82 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ndryshuar, në të cilën përcaktohet, se Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve, si dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Ndërsa, në lidhje me pretendimin mbi mungesën e elementeve plotësuese të këtyre pompave (enë zgjerimi 24 lit për pompën pilot, shunto antivibrant; valvola flutur DN 50, Kolektor dergimi, valvol mos-kthimi DN 50), pra mosparaqitja e tyre në katalog, Komisioni sqaron, se në hartimin dhe përmbushjen e këtij kriteri, autoriteti kontraktor ka vlerësuar të nevojshme paraqitjen edhe të elementëve plotësues të këtyre pompave të Grupit MNZ. Akoma më tej Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje të operatorit ekonomik, se ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesave mbi hartimin e dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, parashikuar nga neni 110 pika 1 e LPP. Konkretisht në nenin 110, pika 1 të ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", parashikohet se "1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë." Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Rezulton se ankimuesi është njohur me dokumentet e tenderit në datën e publikimit të njoftimit të kontratës dhe afatet e ankimit për dokumentet e tenderit të procedurës objekt- ankimi për ankimuesin, nisin nga dita e publikimit të tyre dhe mbarojnë në ditën e shtatë sipas parashikimit ligjor në nenin 110, të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik". Operatori ekonomik është palë e interesuar në përmbushje të të gjitha kërkesave të DST, me qëllim fitimin e kontratës, ndaj ofertimi i mallrave në përputhje me specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim është i rëndësishëm. KPP thekson faktin, se kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm.....

Në lidhje me pretendim e ankimuesit, për arsyen e skualifikimit për pompën SD90 ku në katalog janë paraqitur 4 tipe dhe nuk është markuar modeli të cilit i referohet operatori, Komisioni sqaron, se në seksionin 2 "Objekti i Kontratës" të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

2.15 Pranohen variantet:

Po

Jo X

Pra KPP thekson, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, se nuk do të pranohen variantet. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik ka detyrimin të dorëzojë në cilësinë e pajisjes vetëm një model/variant sipas specifikimeve/karakteristikave të kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Në kuptim dhe në zbatimin të parimit të barazisë në trajtimin e kandidatëve/ofertuesve, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në hartimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit, duhet të tregojë kujdes që të përcaktojë të njëjtat të drejta dhe detyrime në radhët e pjesëmarrësve. Në rastin konkret, KPP gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen e një model/variant sipas specifikimeve/karakteristikave nuk krijon konfuzion tek ofertuesit në plotësimin e kërkesës: KPP gjykon, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, ndërsa ofertat që nuk përputhen në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Në lidhje me pretendim e ankimuesit, për arsyen e skualifikimit për pajisjet nr. 12 dhe nr. 13, ku në katalog janë paraqitur variante dhe nuk është markuar modeli të cilit i referohet operatori, Komisioni sqaron, se në seksionin 2 "Objekti i Kontratës" të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

Pranohen variantet:

Po

Jo
X

KPP thekson, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, se nuk do të pranohen variantet. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik ka detyrimin të dorëzojë në cilësinë e pajisjes vetëm një model/variant sipas specifikimeve/karakteristikave të kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Në kuptim dhe në zbatimin të parimit të barazisë në trajtimin e kandidatëve/ofertuesve, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në hartimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit duhet të tregojë kujdes që të përcaktojë të njëjtat të drejta dhe detyrime në radhët e pjesëmarrësve. Në rastin konkret, KPP gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen e një modeli/varianti sipas specifikimeve/karakteristikave nuk krijon konfuzion tek ofertuesit në plotësimin e kërkesës: KPP gjykon, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, ndërsa ofertat që nuk përputhen në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

KPP me vendimin nr.364/2024 protokolluar me nr.471/8 prot., date 09.04.2024 ka pranuar pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik "INERTI" SHPK.

6. Operatori ekonomik "LIS KONSTRUKSION" sh.p.k. me NUIS: K66613407H pasi nuk përmbush kriteret si më poshtë:

1. Për pikën 2.3.6 ku operatorët për të gjitha artikujt/pajisjet e listuara në tabelën pika 2.3.5 e DST, duhet të paraqesin katalogë ose broshura. Në katalog duhet të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secili nga

artikujt/pajisjet që oferton sipas modelit të deklaruar dhe të markohen dhe specififikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Sa më sipër ky operator nuk plotëson specififikimet konkretisht:

Për pajisjen Nr. 2 Centrali i alarmit:

- Operatori ka paraqitur central alarmi për zjarrin jo per central alarmi të hyrjeve të kontrolluar dhe alarmit për hyrje të padëshiruar me mundësi kominikimi në rrjet.

Për paisjen Nr. 8 është kërkuar Grupi MNZ:

- Tek kjo paisje janë paraqitur vetëm specififikimet për pompat por pa specifikuar mënyrën e vendosjes apo pozicionimin që zënë këto pompa në grupin MNZ. Meqënëse në katalog janë paraqitur elementët veç e veç këtu mungojnë element të grupit MNZ si paneli komandimit dhe presostate për secilën pompë; si dhe Enët e zgjerimit;

- Mungon Enë zgjerimi 24 litra për pompën pilot;

- Mungon Xhunto antivibrant;

- Mungon Valvola flutur DN50;

- Mungon Kolektori dërgimit;

- Mungon Valvola mos-kthimit DN50 është paraqitur DN40.

Për paisjen Nr. 9 është kërkuar Grupi i furnizimit me ujë sanitar:

Tek kjo paisje janë paraqitur në katalog specififikimet për pompën e ujit ku nuk plotësohet specifikimi teknik për:

- Për pompën SD90 nuk është përcaktuar modeli i markuar dhe nuk kuptohet në tabelë cilit model i përket te paraqitur nga operatori

- Mungojnë lidhjet 2” e cila konvertohet me 63mm nuk plotësohet ky specifikim;

- Mungon specifikimi për enën e zgjerimit 25 litra që nuk është paraqitur fare në katalog;

- Nuk plotëson kapacitetin 400V pasi operatori e ka paraqitur 220V-380V.

2. Nuk përmbush kriterin 2.3.6. pasi katalogjet teknike të paraqitura janë në gjuhën anglisht. Në dokumentat e tenderit të hartuara e të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, e konkretisht në kriteret e përgjithshme, të cilat janë detyrimisht për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë, si dhe detyrimisht për të mos u ndryshuar nga autoriteti kontraktor gjatë hartimit të dokumentave të tenderit, është përcaktuar qartë e saktë që “Nëse gjuha e përdorur në procedurë është shqip, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe”, si edhe gjuha e përdorur është përcaktuar në dokumentat e tenderit, Seksioni IV Procedura, pika 4.7 “Gjuha Shqipe”, atëherë i gjithë dokumentacioni i paraqitur në procedurën e prokurimit duhet të jetë në gjuhën shqipe ose i përkthyer i noterizuar në gjuhën shqipe, përcaktim ky gjithpërfshirës që i përket çdo lloj dokumentacioni që do të paraqitet në këtë procedurë prokurimi nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Vendimi i KPP Nr. 254/2018. - Faza: Vleresim Teknik

7. Operatori ekonomik “ERGI” sh.p.k. me NUIS: K02727229P pasi nuk përmbush kriteret si më poshtë:

1. Tek Shtojca 8 lidhur me mjetet Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton ka deklaruar vetëm një nga dy të kërkuara në kriterin 2.3.4. të kapacitetit teknik të kriterëve të veçanta të kualifikimit.

2. Për pikën 2.3.6 ku operatorët për të gjitha artikujt/pajisjet e listuara në tabelën pika 2.3.5 e DST, duhet të paraqesin katalogë ose broshura. Në katalog duhet të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secili nga artikujt/pajisjet që oferton sipas modelit të deklaruar dhe të markohen dhe specififikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Sa më sipër ky operator nuk plotëson specififikimet konkretisht:

Për paisjen Nr. 8 është kërkuar Grupi MNZ:

- Tek kjo paisje janë paraqitur vetëm specififikimet për pompat por pa specifikuar mënyrën e vendosjes apo pozicionimin qe zene keto pompa ne Grupin MNZ. Meqënëse në katalog janë paraqitur elementët veç e veç këtu mungojnë element të Grupit MNZ si Paneli Komandimit dhe presostate për secilën pompë; si dhe Enët e zgjerimit;

